Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 7 • NUMRI 2 • 2010

BIBLIOTEKAT E KOSOVËS
HISTORIA DHE ZHVILLIMI I TYRE

DR. SALI BASHOTA, DREJTOR
(Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës)
&
BESIM J. KOKOLLARI, MAGJISTËR I SHKENCËS SË BIBLIOTEKARISË
(Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës)

Ko kumtesë paraqet dëshmi, fakte dhe argumente lidhur me historikun dhe zhvillimin e bibliotekave të Kosovës. Po ashtu, në këtë kumtesë jepen informacione të sakta për pasojat e dhunës serbe ndaj bibliotekave të Kosovës, në përgjithësi dhe ndaj Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në veçanti, në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX.

Shkrimi bazohet në burime të ndryshme, si raporte, dokumente, fotografi, etj. Gjithsesi këto dëshmi paraqesin vetëm një pjesë të aparteidit kulturor që është ushtruar ndaj institucioneve kulturore dhe arsimore të Kosovës, në këtë rast ndaj bibliotekave, në periudhën e okupimit serb.

Faktet dëshmojnë se vetëm në periudhën e viteve 1998/1999 në Kosovë janë shkatërruar dhe djegur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe 175 biblioteka me një fond prej 1.665.496 ekzemplarësh.

Me gjithë këto humbje të mëdha, bibliotekat e Kosovës, në periudhën pas vitit 1999, kanë filluar të funksionojnë duke i pasuruar fondet e tyre dhe duke i ruajtur të gjitha koleksionet e trashëguara bibliotekare, përfshirë edhe ato të gjuhëve të pakicave. Në fund jepet edhe një përmbledhje e shkurtër e veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në dekadën e fundit për të treguar orientimin e saj drejt zhvillimit dhe të ardhmes së saj.

/ VIJON NË FAQEN 6 /

* *Kumtesa "Bibliotekat e Kosovës: Historia dhe Zhvillimi", e prezantuar në sesionin e Historisë së Bibliotekave-SIG, në kuadër të Kongresit të 76-të të IFLA-s, të mbajtur në Gothenburg (Suedi), më 14 gusht 2010, botohet në shqip dhe anglisht. Versioni anglisht i kumtesës gjendet i botuar në punimet e Kongresit të IFLA-s në: http://www.ifla.org/files/hq/papers/ifla76/136-bashota-en.pdf*

* *The paper "Kosova Libraries: History and Development" was presented at the History of Libraries-SIG Session of the 76th IFLA Congress held in Gothenburg (Sweden) on August 14, 2010. The paper is published in both Albanian and English. The presented version of the paper can be found on the IFLA's Congress proceeding at: http://www.ifla.org/files/hq/papers/ifla76/136-bashota-en.pdf*

ABEK NDIHMON PËRDORUESIT NË FUSHËN E KËRKIMEVE SHKENCORE

Prishtinë, 27 shtator - 1 tetor 2010

Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), nga data 27 shtator deri më 1 tetor 2010, ka organizuar në Prishtinë trajnime në bazën e të dhënave të EBSCO-s, për të gjithë udhëheqësit e kërkimeve elektronike të BKUK-së, të bibliotekave të Universitetit të Prishtinës, si dhe të bibliotekave të kolegjeve private në Kosovë. Trajnimet janë zhvilluar në qendrën e trajnimit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe në Fakultetin e Mjekësisë, përkatësisht në Qendrën e Telemjekësisë.

Ky asociacion u ka mundësuar të gjithë specialistëve të shohin praktikisht format e kërkimeve në bazën e të dhënave EBSCO dhe EBSCOhost interface, baza të të dhënave këto që tashmë janë siguruar për përdoruesit në Kosovë. Duke qenë se EBSCO është një ndër platformat më të njohura në kërkimet akademike dhe shkencore - shumë e pasur dhe e rëndësishme, studiuesit e Kosovës do të kenë mundësinë të hulumtojnë në përmbajtjen e kësaj baze të të dhënave.

Mehmet Can Soylmaz nga Turqia, specialist i këtyre kërkimeve dhe përfaqësues i EBSCO-s, gjatë kësaj kohe sa ka zgjatur trajnimi, ka mbajtur ligjërata për tema dhe probleme të ndryshme të një rëndësie të veçantë në fushën e kërkimeve në burime elektronike, duke përfshirë, në këtë kontekst, edhe fusha të kërkimit elementar dhe administrimit të EBSCO-s.

Për të gjithë përdoruesit, që kërkimin e tyre e bëjnë në biblioteka të Kosovës, Universitetin e Prishtinës, si dhe në kolegjet private, kanë mundësi që nëpërmjet shërbimeve të EBSCO-së, të kenë qasje në një numër të madh të bazave të dhënave bibliografike dhe me tekst të plotë, të cilat plotësojnë nevojat për informacion të të gjitha llojeve të bibliotekave kudo në botë.

EBSCO ka publikime dhe shërbime të specializuara për biblioteka universitare, mjekësore, qeveritare, shkollore dhe publike, si dhe për institucione dhe gazeta, duke përbërë një bazë të të dhënave me mëse 60.000 botues nga mbarë bota.

Për të gjithë përdoruesit, që kërkimin e tyre e bëjnë në biblioteka të Kosovës, Universitetin e Prishtinës, si dhe në kolegjet private të lartpërmendura, kanë mundësi që nëpërmjet shërbimeve të EBSCO-së, të kenë qasje në një numër të madh të bazave të dhënave bibliografike dhe me tekst të plotë, të cilat plotësojnë nevojat për informacion të të gjitha llojeve të bibliotekave kudo në botë.

Pra, qasja në burimet elektronike u mundësohet të gjithë përdoruesve të BKUK-së, atyre të Bibliotekave Ndërkomunale, përdoruesve nga Universiteti i Prishtinës, si dhe kolegjeve: Victory, UBT, Pjetër Budi, Kolegji për Studime të Menaxhmentit Internacional, AAB-RIINVEST, si dhe Kolegji FAMA, institucione këto që kanë mundësuar, duke siguruar mjete të mjaftueshme financiare për parapagimin, qasje në këto burime elektronike. Pra ky është një grup bibliotekash të bashkuara, që synon të rrisë fuqinë në sigurimin e shërbimeve elektronike.

B. HALITI

Në këtë numër

KOSOVA LIBRARIES: HISTORY AND DEVELOPMENT.....14

SFIDAT E ZHVILLIMI TË KOLEKSIONEVE NË BIBLIOTEKAT E FAKULTETEVE TË KOSOVËS 22

LEXIMI I LETËRSISË SHQIPE NË BKUK.....24

TAVOLINA REFERALE - NJOHJA ME BIBLIOTEKËN.....26

BKUK – NEVOJA PËR KRIJIMIN E BIBLIOTEKËS DIGJITALE 28

LIGJI PËR BIBLIOTEKAT DHE NEVOJA E RISHIKIMIT 30

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Bukurije Haliti, Izet Abdyli, Muharrem Halili, Bedrije Mekolli
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

JAVA E BIBLIOTEKËS - 2010

Hapja solemne e Edicionit VIII të Javës së Bibliotekës në Kosovë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, nga 12 deri më 17 prill 2010, organizuan edicionin VIII të Javës së Bibliotekës në Kosovë.

Manifestimi qendror është mbajtur në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ndërsa janë zhvilluar aktivitete edhe në bibliotekat e qytetit të Prishtinës, të Prizrenit dhe të Gjakovës. Gjatë kësaj Jave u organizuan aktivitete të rëndësishme, si: ligjërata të veçanta nga fusha e bibliotekarisë, e trashëgimisë kulturore të Kosovës, e arsimit, si dhe ligjërata speciale kushtuar jetës dhe veprës së Fehmi Aganit. Gjithashtu, u mbajtën edhe promovime, ekspozita të librave të rrallë, të fotografive të vjetra të qytetit të Prizrenit, si dhe të qytetit të Prishtinës, ekspozita me vepra të artistëve të rinj, etj.

Java e Bibliotekës në Kosovë është hapur nga drejtori i BKUK-së - dr. Sali Bashota, i cili foli për rëndësinë e kësaj Jave si një ngjarje kulturore e vitit për librin dhe bibliotekat, e cila ka peshë kulturore për zhvillimin e kulturës dhe të bibliotekave në Kosovë.

Ndërsa në një fjalim, në hapje të Javës, Zëvendës-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Michael J. Murphy, uroi për zhvillim të mirë dhe arritje të rezultateve gjatë kësaj Jave, duke theksuar përkushtimin e Ambasadës për përkrahje në përgatitje profesionale të stafit, modernizim të shërbimeve, si dhe pasurim të koleksioneve të BKUK-së.

Ky manifestim është përshëndetur edhe nga - dr. Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i cili ka folur për mbështetjen e vazhdueshme që do t'i jepet BKUK-së, në

mënyrë që biblioteka të krijojë kushte për përdoruesit e saj - për qytetarët e Republikës së Kosovës, që ata të jenë pjesë e kulturës së leximit, e të shtetit të dijes.

***

Aktivitetet e Javës së Bibliotekës në Kosovë kanë filluar me ligjëratën speciale të mbajtur nga dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, me temën "Albania" e Konicës për "ne" dhe për "të tjerët", (ligjëratë e mbajtur gjatë një ceremonie solemne me rastin e dhurimit nga BKSh të revistës së plotët të digjitalizuar "Albania" të Faik Konicës për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës), i cili ka folur për rëndësinë kulturore të kësaj reviste dhe mundësitë që tashmë ofrohen, (pas digjitalizimit të përmbledhjes 12-vëllimshme të revistës "Albania" të Faik Konicës) nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, për të gjitha institucionet hulumtuese e arsimore, si dhe për të gjithë përdoruesit e saj.

Ligjërata e Catherine Marsicek, Zyrtare për burime të informacionit për Austri, vende të Ballkanit, dhe të Kaukazit, në Ambasadën Amerikane në Vjenë, me temën "Trendet e reja në bibliotekarinë amerikane", ishte me interes për bibliotekarët pjesëmarrës - për t'u njohur me përvojat që aplikohen në fushë të bibliotekarisë bashkëkohore. Marsicek foli për zhvillimin e bibliotekave në SHBA, të cilat në dekadat e fundit kanë marrë drejtime të reja, duke u bërë qendra të komunitetit dhe teknologjive të reja të informacionit.

Cikli i ligjëratave për Koleksionet e Veçanta, është hapur me diskutimin e Etleva Domit, zëvendës-drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, e cila në ligjëratën e saj me temën "Koleksionet e veçanta në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë", ka folur për pasurimin, ruajtjen dhe rëndësinë kulturore të koleksioneve të rralla në BKSh, të cilat, ndonëse të pakta n numër, krahasuar me krejt fondin e saj, tërheqin vëmendjen për vlerat e tyre të veçanta.

Një seri temash për problemin e Koleksioneve të Veçanta, janë mbajtur nga bibliotekarë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Jehona Shala në ligjëratën e saj me temën "Rivizitimi i Koleksioneve te Veçanta", ka folur për rivizitimin, që sipas saj, në diskursin teorik të dijeve humane përafërsisht nënkupton rishqyrtimin e një pune paraprake me tendencën për ta rifreskuar e pasuruar atë; pra kjo e nderon klasiken duke e bërë atë të përdorshme edhe për modernen.

Nehat Krasniqi, në ligjëratën: "Bibliotekat e periudhës osmane në trojet shqiptare në dritën e dorëshkrimeve", ka dhënë një historik të ekzistimit të këtyre bibliotekave, mbështetur mbi të dhënat e dorëshkrimeve, sipas të cilave, biblioteka me e vjetër, sipas të dhënave - e themeluar në trojet shqiptare, është ajo e Medresës së Ishak Beut në Shkup, e ngritur rreth vitit 1411 dhe e vakëfuar në vitin 1444.

Edona Munishi - Kokollari, në ligjëratën: "Biblioteka Muzikore: e ardhmja shpirtërore dhe materiale", ka shtjelluar problemin e zhvillimit të Bibliotekës Muzikore në rrafshin e hartimit të rregulloreve të pasurimit të koleksioneve muzikore, kthimit të kulturës së shkruar apo të dokumentuar të orientimeve të përgjithshme të kësaj biblioteke, si dhe vetë pasurimin me tituj të rinj, duke ofruar dhe propozuar gjithnjë mënyra të zgjidhjeve të këtyre problemeve.

Adil Olluri në ligjëratën e tij me temën: "Rëndësia e Bibliotekave legatë për BKUK-në dhe kulturën shqiptare në Kosovë", ka folur për rëndësinë e Bibliotekave legatë, veçanërisht për Bibliotekat legatë të Fehmi Aganit dhe Krist Malokut, për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe kulturën shqiptare në Kosovë. Rëndësia e tyre është trajtuar në tri dimensione: bibliotekare, kulturore dhe shkencore.

Jetish Kadishani ka folur për "Historikun e fotografisë në Kosovë", duke i dhënë rëndësi historikut të fotografisë në vendin tonë që sipas hulumtimeve të bëra deri më tani fotografia zë fill që në fillimi të shekullit XX, me fotografët e Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Prishtinës, Mitrovicës, Janjevës, etj.

Albanë Mehmetaj në ligjëratën e saj me temën: "Hylli i Dritës", ka folur për rëndësinë kulturore të kësaj reviste - si e para e botuar brenda territorit të Shqipërisë, e cila mblodhi rreth vetes, elitën e "uritur" shqiptare për të shpërthyer me sfera të ndryshme të dijes. Që në fillime atë e mbërthyen intelektualë shqiptarë të krishterë, por edhe të tjerë, për t'u bërë ngadalë një tribunë shqiptare në plot kuptimin e fjalës.

Bedrije Mekolli, në ligjëratën: "Roli dhe përgjegjësia e Sektorit të Restaurimit dhe Konservimit", ka folur për aktivitetet e këtij sektori dhe mënyrën se si ruhen librat e rrallë nga dëmtimet e mundshme, me theks të veçantë ato në BKUK.

Një sesion tjetër në kuadër të Javës së Bibliotekës në Kosovë, i është kushtuar jetës dhe veprës së akademik Fehmi Aganit. Në këtë sesion ka referuar Akademik Rexhep Ismajli, i cili e ka vlerësuar figurën e akademik Fehmi Agani si njeri të librit, në konceptin e tij të botës së librit dhe të krijimtarisë shkencore e shkrimore. Duke folur për kontributin e Aganit në politikë, akademik Ismajli ka theksuar se në gjithë veprimtarinë e tij, ka qenë elaborimi dhe mbrojtja e idesë së pavarësisë së Kosovës.

Për figurën e Fehmi Aganit, ka folur edhe zëvendës-ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - dr. Agim Hyseni, i cili tha se Fehmi Agani ishte një ndër vendimtarët dhe veprimtarët më të ndërgjegjshëm e më të përgjegjshëm, si dhe ndër më të shquarit e shkencave shoqërore politike e të lëvizjes politike shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Ndërsa dr. Mentor Agani, duke folur për figurën e të atit të tij - akademik Fehmi Agani, tha me emocion se për fare pak nuk ia doli ta shohë dhe të marrë pjesë në vendosjen e kulmit të godinës së shtetësisë së Kosovës, mirëpo ai së bashku me shokët dhe kolegët e tij Gazmend Zajmi, Ali Hadrin, Dervish Rozhajën e shume të tjerë, ishte njëri ndër individët kryesorë që i vendosen themelet e kësaj godine.

Gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë, është mbajtur edhe sesioni për trashëgiminë Kulturore në Kosovë. Në këtë sesion, drejtori i Arkivit të Kosovës - Jusuf Osmani foli për "Arkivat dhe dokumentet arkivore", duke theksuar rëndësinë e arkivave në mbrojtje të thesarit kulturor të një populli.

Kryetarja e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Edi Shukriu, mbajti ligjëratën me titull: "Trashëgimia kulturore- identiteti i Kosovës", në të cilën u shpreh për përkujdesje më të madhe në mbrojtje të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

"Stela e kalorësitë dardanë nga Ulpiana", ishte tema për të cilën ligjëroi Haxhi Mehmetaj, drejtori i Institutit për Monumenteve Kulturore dhe i Muzeut të Prishtinës. Sipas tij, zbulimi i këtij monumenti sepulkral është me vlerë për njohje të kulteve, të antroponimisë dhe artit të popullatës së Ulpianës, në veçanti, dhe të Dardanisë, në përgjithësi.

Pjesëmarrës në Javën e Bibliotekës

***

Këndi Amerikan, i cili gjendet në kuadër të BKUK-së, gjatë Javës, zhvilloi aktivitete të ndryshme për pesë ditë me radhë, ndërsa aktivitete u zhvilluan edhe në bibliotekat ndërkomunale të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës, si dhe në Bibliotekën e Universitetit Amerikan në Kosovë.

Në këtë Javë, u bë hapja solemne e bibliotekës së shkollës fillore "Xhemajl Mustafa", në ceremoninë e së cilës mori pjesë edhe presidenti i Republikës së Kosovës - Z. Fatmir Sejdiu.

Gjatë kësaj Jave, u organizua Dita e Dhurimit të Librit, me ç'rast u promovua granti i dhënë nga ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vlerë prej 40.000 dollarësh për blerjen e librave universitare. Po ashtu është bërë edhe zyrtarizimi i investimit të ProCredit Bank-ës për rregullimin e Qendrës së Trajnimeve në vlerë prej 23.000 eurosh. Donacione të tjera të rëndësishme janë dhënë edhe nga IPKO për rrjet të internetit falas për bibliotekat e Kosovës - për BKUK-në dhe shtatë bibliotekat e qyteteve kryesore të Kosovës; donacioni tjetër ishte edhe ai i shtëpisë botuese "Robert OLMS" nga Gjermania, e cila i ka dhuruar BKUK-së libra në vlerë prej 31.300 eurosh.

BKUK, gjatë kësaj Jave i ndau mirënjohje për punëtore e dalluar - Nexhbedije Rizës, bibliotekare e Departamentit të Katalogimit; student i dalluar - Faton Bujupit, si dhe gazetar i dalluar, (për përcjellje të aktiviteteve dhe punës së BKUK-së), gazetarit të gazetës ditore "Kosova Sot" - Isa Vatovci.

Në përmbyllje të aktiviteteve të Javës, është mbajtur koncert i muzikës klasike nga pianisti i njohur nga Shqipëria, i cili jeton në Gjermani - Desar Sulejmani. Ky koncert u sponsorua nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë.

Mund të thuhet se forma e këtyre aktiviteteve të organizuara, temat dhe referimet nga ekspertë të fushave të ndryshme gjatë kësaj Jave, kanë evidentuar, shtruar e vlerësuar shumë probleme që përcjellin kulturën dhe bibliotekat në Kosovë.

Durim HASAJ

BIBLIOTEKAT E KOSOVËS HISTORIA DHE ZHVILLIMI I TYRE

HYRJE

Kumtesa është shkruar si reagim ndaj artikullit të autorëve serbë të paraqitur në Kongresin e 75-të të IFLA-s në Milano, të Italisë, në vitin 2009, dhe ka për qëllim të ofrojë disa informacione dhe fakte lidhur me Kosovën në përgjithësi, dhe me zhvillimin e bibliotekave, në veçanti. Për fat të keq, autorët serbë në artikullin e tyre ndjekin mentalitetin e vjetër serb të përvetësimit të historisë dhe kulturës së tjetrit, në këtë rast të trashëgimisë kulturore të Kosovës, duke pretenduar në përvetësimin e fakteve historike, si të objekteve të kultit, po ashtu, edhe të bibliotekave, e në mënyrë të veçantë edhe të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Këto pretendime nuk janë të parat të këtij lloji kundër trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ndërsa dihet fare mirë që ishte regjimi serb i Millosheviqit me makinerinë e tij, i cili shkatërroi, dogji jo vetëm objektet kulturore në Kosovë gjatë luftës 1998/1999, por edhe depërtoi mëse 1 milion shqiptar nga shtëpitë e tyre. Dora e këtij regjimi për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore të popujve të tjerë, përfshirë edhe bibliotekat, ndihej gjithandej në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë (Shih Riedlmayer, 2007).

Në bazë të fakteve historike, i tërë rripi i bregdetit Adriatik banohej prej paraardhësve të shqiptarëve, ilirëve. Ndërsa, është fakt se sllavët në Ballkan u dynden mes shekullit të VII-X, e ndërsa krishterimi i tyre filloi vetëm në shekullin X-të. Në këtë drejtim dëshirojmë të japim disa shembuj të përvetësimit të historisë dhe trashëgimisë së lashtë kulturore të Kosovës, apo më saktë, të shqiptarëve nga serbët. Një shembull tipik është rindërtimi i kishave mbi themelet e kishave ilire. Shembull të këtij përvetësimi historik e kulturor paraqet kisha Holy Virgin of Ljevisa e shekullit të XIV-të e mbretit Milutin që është e ndërtuar mbi themelet e bazilikës ilire të shekullit të VI në qytetin jug-lindor të Prizrenit (Hoddinott, 1963). Kjo kishë përmendet në artikullin e autorëve serbë Simocic dhe Vukadinovic (2009 f. 11). Edhe një varg kishash të tjera janë ndërtuar me këtë qëllim të humbjes së gjurmëve të trashëgimisë iliroshqiptare. Një shembull tjetër, po ashtu, tepër shqetësues, paraqet edhe lufta e fundit e viteve 1998/1999 ku artefaktet më të rëndësishme ilire janë vjedhur nga Muzeu i Kosovës dhe muze të tjera duke u dërguar në Beograd për gjoja një ekspozitë, pikërisht në ditën e fillimit të bombardimeve të NATO-s më 24 mars (Riedlmayer, 2000). Këto artefakte edhe sot e kësaj dite nuk janë kthyer në shtëpinë e tyre në Kosovë.

Për të sjellë argumente të shumta lidhur me historinë e Kosovës dhe të shqiptarëve në gadishullin ballkanik ka shumë fakte dhe argumente që dëshmojnë përhershmërinë e iliroshqiptarëve në këto treva para serbëve. Megjithatë, në këtë kumtesë synimi ynë është përqendrimi në historinë dhe zhvillimin e bibliotekave, duke përfshirë edhe një pasqyrë të shkurtër të Kosovës në dekadat e fundit.

KOSOVA NJË VËSHTRIM I SHKURTËR

Kosova një vend i vogël, por tepër karakteristik me veçoritë e saj politike, gjeografike, historike, shoqërore dhe kulturore, zë një vend të veçantë në zhvillimet ballkanike dhe evropiane. Kosova më 17 shkurt 2008 shpalli pavarësinë e saj, duke u bërë kështu shteti më i ri në botë me synime të qarta të integrimit evropian dhe botëror. Që prej atëherë ajo është njohur prej 69 shteteve (sipas të dhënave të datës 19 maj 2010).

Në aspektin gjeografik, Kosova shtrihet në një territor prej 10.908 km2 me klimë kontinentale dhe kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Ka pasuri të mëdha natyrore, me tetë lumenjtë kryesorë që shtrihen në gjatësi prej 511 km brenda territorit të Kosovës; ka katër liqene më të mëdhenj dhe një varg liqenesh të vegjël natyrorë. Maja më e lartë në Kosovë është ajo e Gjeravicës në jugperëndim të Kosovës me 2.656 metra mbi nivelin e detit (Enti i Statistikës së Kosovës, 2008). Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina.

Sipas statistikave të fundit të Entit të Statistikave të Kosovës popullsia e Kosovës është 2, 180,686 banorë me një natalitet prej 16% dhe mortalitet prej 3.2%. Prej tyre, vlerësohet se 92% janë shqiptarë, 5.3% serbë dhe 2.7% grupe të tjera etnike. Kosova ka po ashtu një popullsi relativisht të re ku 33% janë prej 0-14 vjet, 61% janë prej moshës 15-64, dhe vetëm 6% janë mbi moshën 65 vjet (Enti i Statistikave të Kosovës, n.d.).

Rendi i ri shoqëror në Republikën

Figura 1: Harta e Kosovës[1]

e Kosovës bëri që përherë të parë kosovarët t'i marrin në dorë, natyrisht me ndihmën ndërkombëtare, zhvillimin e politikave ekonomike,, arsimore, kulturore, etj. Së këndejmi, Qeveria e Kosovës i ka dhënë rëndësi shumë të madhe sistemit arsimor, duke e bërë atë më prioritarin, dhe duke e shpallur Kosovën "shtet të dijes" me bindjen se një shtet i arsimuar do të krijojë kuadro të afta për uljen e papunësisë së madhe në Kosovë që varion mes 30-40%, do t'i ndihmojë individit në vetëpunësim, dhe ta bëjë atë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tij shoqërore. Sipas Entit të Statistikës së Kosovës (2004), analfabetizmi në Kosovë sillet në përqindje afër 8 % të moshës së rritur me një dallim të theksuar mes popullsisë rurale dhe urbane si dhe në mes përkatësisë gjinore. Më tej, sipas këtij Enti, theksohet se "... te grupet më të reja analfabetizmi është në zhdukje e sipër". Kjo dukuri pritet të zhduket tërësisht edhe me masat e fundit në bërjen e arsimit parafillor, fillor, të mesëm të ultë dhe të lartë në arsim të detyrueshëm në Kosovë.

Natyrisht se këto fenomene, si ai i analfabetizmit dhe papunësisë, i kanë rrënjët në historinë e kaluar të Kosovës së pushtuar, ku duhet cekur se shqiptarëve iu lejua për herë të parë shkollimi superior vetëm pas vitit 1970 me hapjen e Universitetit të Prishtinës. Hapja e këtij Universiteti u shoqërua me shumë presione politike të regjimit ish-jugosllav, megjithatë mbijetoi gjatë tërë kohës. Megjithëse në Kosovë kishte filluar të krijohej dhe stabilizohej një ekonomi e shëndoshë gjatë viteve '70-ta dhe '80-ta; gjithçka u rrënua në vitin 1989 me suprimimin e kushtetutës së Kosovës dhe largimin nga puna të punëtorëve shqiptarë nga regjimi serb i Millosheviqit. Një fat i tillë, i përcolli edhe punonjësit e bibliotekave të Kosovës, të cilët së bashku me kolegët e tyre në sektorët e tjerë publikë të Kosovës qëndruan jashtë këtyre institucioneve për dhjetë vjet me radhë, d.m.th. në periudhën e viteve 1990-1999.

ZHVILLIMI HISTORIK I BIBLIOTEKAVE TË KOSOVËS

Burimet e ndryshme vënë në dukje se historiku i bibliotekave në Kosovë daton nga periudha të hershme, madje edhe në shekujt XIV-XV. Biblioteka e Suzi Qelebiut (1513) në Prizren konsiderohet si një ndër bibliotekat e para në Kosovë. Funksioni i shumë bibliotekave atëherë në Kosovë është i ndërlidhur kryesisht me misionin e bashkësive të kultit. Kjo traditë ka vazhduar në periudha të ndryshme deri në shekullin e XX-të kur edhe paraqiten bibliotekat e para me karakter institucional.

Në vitin 1944 në Prizren është themeluar institucioni i parë publik bibliotekar në Kosovë. Prandaj, themelimi dhe zhvillimi i bibliotekave në Kosovë, gjithsesi, pikë referimi e ka Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, e cila ka kaluar nëpër disa faza, madje duke

[1]Source: http://www.courts.state.nh.us/supreme/newsletter/winter_08/kosovo.htm



Ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë

marrë emërtime të ndryshme: Biblioteka Regjionale e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1944-1952), Qendra Bibliotekare e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1956-1961), Biblioteka Popullore Krahinore (1961-1970), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës (1970-1990), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës e Metohisë (1990-1999), ndërsa nga viti 1999-Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar. Objekti në foton e mësipërme është inauguruar në vitin 1981. Aktiviteti i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është i ngjashëm sikundër bibliotekat e tjera kombëtare në shtete të ndryshme të botës, edhe si anëtare në institucione të ndryshme ndërkombëtare. Veprimtaria bibliotekare zhvillohet edhe në bibliotekat ndërkomunale në Kosovë, të cilat konsiderohen si biblioteka të nivelit të dytë. Këto biblioteka funksionojnë në qendrat më të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Leposaviq, ndërsa bibliotekat komunale në qytete më të vogla të Kosovës konsiderohen si biblioteka publike të nivelit të tretë.

Me rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në vitin 1989, veprimtaria bibliotekare, sikundër edhe në sferat tjera në kulturë, arsim e shkencë, u diskriminua nga pushteti serb. Periudha e viteve 1998-1999 është periudha e okupimit dhe e inkuizicionit, pra e shkatërrimit, zhdukjes dhe e djegies së koleksioneve bibliotekare në shumë biblioteka publike dhe private në Kosovë.

Nga viti 1990 deri në vitin 1999 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës pushteti okupues serb aplikoi masat e dhunshme kur u mohohej e drejta lexuesve shqiptarë për shërbime. Këto masa të dhunshme u instaluan në këtë institucion me vendim të Kuvendit të Serbisë, të botuar në gazetën zyrtare nr. 40/90, 53/90 dhe 54/90. Hapi i parë i këtyre masave ka qenë largimi sistematik nga puna i punëtorëve bibliotekarë shqiptarë dhe joserbë. Pra, gjatë kësaj periudhe janë larguar 91 punëtorë bibliotekarë dhe është bërë zëvendësimi i tyre me punëtorë serbë. Pos që ishte mbushur me refugjatë serbë nga Kroacia dhe Bosnja, në periudhën mars-maj 1999, gjatë ndërhyrjes së NATO-s, ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ishte edhe bazë e ushtrisë serbe prej periudhës 5.04.1999 deri më 14.06.1999. Kjo dëshmohet edhe sipas dokumentit me numër 1351 të Komandës së ushtrisë serbe të datës 14.06.1999, dokument që ruhet në arkivin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Nuk ishte vetëm Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, objekti i së cilës u përdor nga ushtria serbe, por kishte edhe objekte të tjera të kulturës e trashëgimisë, si Kisha katolike e Shën Antonit në Prishtinë, si dhe ajo në Gjakovë (Herscher & Riedlmayer, 2001, f. 9), pastaj Arkivi i Kosovës, Instituti i Historisë (Riedlmayer, 1999-2000), që ishte të ndaluara sipas ligjeve të luftës.

Gjithashtu, në periudhën e administrimit serb Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës i janë shtuar 22.000 libra, të gjitha në gjuhën serbe dhe asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa po në këtë periudhë 125.981 materiale bibliotekare në gjuhën shqip janë zhdukur nga administrata e dhunshme e këtij institucioni dhe janë dërguar në fabrikën e letrës në Lipjan të Kosovës (BKUK, raporti nr. 11, 2006). Po kështu, në këtë institucion është bërë edhe një spastrim i madh i koleksioneve me vlerë nacionale, sidomos veprat e autorëve të traditës shqipe. Përveç këtyre dëmeve, në mënyrë të dhunshme, Republika e Serbisë, përkatësisht Ministria e Kulturës me dokumentin 630-02-32/99-34 të datës 8 shkurt 1999 ia ndryshon emrin e Bibliotekës në Bibliotekë Kombëtare dhe Universitare "Ivo Andric" (Dokumenti i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Serbisë, nr. 630-02-32/99-34, 1999).

Fotografia e epërme paraqet një kamion duke pritur që të ngarkohet para Bibliotekës Kombëtare dhe



Komioni duke pritur dhe librat e paketuara për t'u ngarkuar dhe dërguar për asgjësim

Universitare të Kosovës. Fotoja e mëposhtme tregon grumbujt e librave që presin të ngarkohen në kamion për t'u dërguar për asgjësim në fabrikën e letrës në Lipjan (fotoja prej Ilaz Bylykbashit, 1996).

Në shkallë vendi gjatë kësaj periudhe u asgjësuan 65 biblioteka publike me një fond prej 968.233 ekzemplarësh (Shih po ashtu Riedlmayer, 2007, p. 122-126). Po ashtu u dogjën 14 biblioteka speciale me një fond prej 145.105 ekzemplarësh, pastaj 86 biblioteka shkollore me një fond prej 325.415 ekzemplarësh, 10 biblioteka të shkollave të mesme me një fond prej 226.743 ekzemplarësh. Kështu, gjithsej në Kosovë janë djegur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe 175 biblioteka me një fond prej 1.665.496 ekzemplarësh (Gjenocidi serb ndaj librit shqip në Kosovë 1998/1999, 2000). Në këto statistika nuk janë përfshirë bibliotekat private, pjesa më e madhe e tyre janë djegur tërësisht. Në këtë periudhë nga forcat serbe u vranë edhe 6 bibliotekarë. Edhe ato pak biblioteka që i shpëtuan djegies, megjithatë iu shkatërruan koleksionet dhe infrastruktura e tyre pothuajse tërësisht, duke i lënë jashtë funksionit të tyre.

Për një shkatërrim, djegiet, dëmet si dhe gjendjen e bibliotekave të Kosovës që dolën prej luftës së vitit 1998/1999 flet edhe raporti i Komitetit për qasje të lirë në informacion dhe liri të shprehjes (FAIFE) të autorëve Carsten Frederiksen and Frode Bakken (2000).

Ky libër inventari dëshmon për largimin dhe asgjësimin e shumë librave të vlefshëm në gjuhën shqipe prej Bibliotekës Kombëtare dhe



Pamje nga libri i inventarit

Universitare të Kosovës nga masat e dhunshme serbe. Rrethi i gjelbër në të majtë tregon datën e regjistrimit të librit, d.m.th. më 22. V. '81, ndërsa rrethi i gjelbër në të djathtë tregon datën e intervenimit në inventar, d.m.th. revizioni në vitin 1998, si dhe pranë tij numri i kopjeve të larguara në ngjyrë hiri.

Libri dhe bibliotekat në Kosovë kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit dhe të ndërprerjes. Faktet dhe dëshmitë tregojnë për fazat e zhvillimit dhe të afirmimit normal të veprimtarisë botuese dhe bibliotekare, por edhe për fazat e diskriminimit dhe të okupimit, duke filluar sidomos nga vitet '80-ta të shekullit XX e deri në vitin 1999.

Zhvillimet e reja në sistemin bibliotekar në Kosovë, kryesisht kanë të bëjnë me modernizimin e shërbimeve përmes teknologjisë së re të komunikimit dhe të qasjes së lirë në burimet e informacionit.

KOLEKSIONET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Koleksionet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës numërojnë rreth 2 milionë ekzemplarë, si libra, revista, gazeta, harta, muzikale, fotodokumente, etj. Përbërja e koleksionit pasqyron përkatësitë etnike të Kosovës, si dhe ka koleksione edhe në gjuhë të tjera të ndryshme të botës. Kohëve të fun-

Shkolla dhe shkolla bibliotekë në rajonin e Klinës e djegur nga forcat serbe në 1998/99

dit, gjithashtu, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka një orientim drejt ofrimit për përdoruesit e vet të burimeve elektronike të revistave më të njohura në botë.

Paraqitja kuantitative më poshtë përbën një pasqyrë të koleksioneve të saj të përpunuara në katalogun e saj elektronik. Këto statistika nuk paraqesin tërësinë e koleksioneve që ruhen në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, por vetëm ato të përpunuara në katalogun e saj elektronik. Këto statistika si dhe statistikat pasuese të koleksioneve të bibliotekave të Serbisë kanë për synim që t'i ndalin ato spekulime se gjoja "nuk ka komb evropian sot bibliotekat e të cilit.... janë më të rrezikuarat se koleksionet e librave serbë në Kosovë..." (Simon i & Vukadinovi , 2009, f. 4). Si dhe për të zhbërë tezën e autorëve në fjalë se gjoja koleksionet bibliotekare në serbisht janë dërguar në Bibliotekën Kombëtare të Serbisë gjoja për t'i mbrojtur nga shkatërrimi (Simon i & Vukadinovi f. 11).

Kjo është edhe një dëshmi tjetër që shteti serb kishte organizuar gjithçka për të vjedhur trashëgiminë kulturore e historike të popullit të Kosovës, ashtu siç kishte plaçkitur edhe artefaktet nga Muzeu i Kosovës e shumë muze e biblioteka të tjera për të cilat kemi folur më lart. Pa marrë parasysh se cilës përkatësi etnike i takojnë ato materiale, ato e kanë vendin në Kosovë e jo në Serbi, pasi ato janë trashëgimi e Kosovës.

Së këndejmi, statistikat e në vijim dëshmojnë praninë, ruajtjen dhe përpunimin, edhe para botës, se materialet bibliotekare në gjuhën serbe dhe gjuhë të tjera në Bibliotekën kryesore të Kosovës trajtohen me të njëjtin nivel, siç trajtohet çdo material tjetër bibliotekar pa ndonjë dallim apo paragjykim gjuhësor, kulturor apo historik.

Prej vitit 2005, kur Biblioteka kishte filluar për herë të parë të bënte përpunimin elektronik të materialeve bibliotekare përmes programit të saj të automatizuar Aleph 500, janë përpunuar 40,220 tituj që rezultojnë në 101,367 ekzemplarë të përpunuara. Këto statistika janë nxjerrë prej katalogut elektronik të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës[2] më 19 prill 2010. Tabela 1 në vijim paraqet ndarjen gjuhësore të këtyre 40,220 titujve të përpunuar. Për nxjerrjen e tyre është përdorë metoda e përpiktë e kërkimit sipas gjuhës në katalogun elektronik - WLN = Word from Language, që pasohet nga kodi i gjuhës sipas formatit MARC, d.m.th. WLN = (ALB) për gjuhën shqipe, ose sipas gjuhëve të tjera përkatëse të paraqitura më poshtë, si WLN = (SCC), WLN = (ENG), etj.

Tabela 1: *Titujt sipas ndarjes gjuhësore*

Nr.	Kodi i gjuhës	Nr. i titujve	Nr. i titujve në përqindje
1.	Alb (Albanian)	21,160	52.6 %
2.	Scc (Serbian)	4,924	12.2 %
3.	Eng (English)	7,958	19.7 %
4.	Fre (French)	2,719	6.7 %
5.	Slv (Slovenian)	715	1.7 %
6.	Mac (Macedonian)	171	0.4 %
7.	Bos (Bosnian)	241	0.6 %
8.	Rus (Russian)	195	0.5 %
9.	Të tjera	2,137	5.6 %
	Gjithsej	**40,220**	**100%**

[2]Katalogu elektronik i Bibliotekws Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, URL: www.biblioteka-ks.org/Katalogu.php

Siç shihet, materiali në gjuhën serbe përbën më tepër se 12% të të gjithë materialit të përpunuar, ndërsa në gjuhët sllave (serbisht, sllovenisht, maqedonisht, boshnjakisht, rusisht) përbën 15.4% të koleksioneve të kataloguara në BKUK. Duke pasur parasysh se në Kosovë ka 5-7% të popullsisë me origjinë sllave, përqindja e koleksioneve të përpunuara në këto gjuhë e tejkalon çdo standard sipas konventave ndërkombëtare të respektimit të pakicave kombëtare, si dhe dëshmon edhe njëherë politikat e drejta që i ndjek Biblioteka Kombëtare dhe Universitare karshi materialeve bibliotekare në gjuhët e ndryshme. Si rrjedhojë, si mund të bëhet fjalë apo pretendohet për shkatërrim koleksionesh përderisa ato përpunohen dhe ruhen nga institucionet bibliotekare të vendit.

Statistikat në Tabelën 2 dhe 3 janë nxjerrë prej sistemit COBISS të Bibliotekës Kombëtare të Serbisë[3] dhe Katalogut virtual të Serbisë në sistemin COBISS[4] me 117 biblioteka të përfshira në këtë rrjet. Tabela 2a dhe 2b janë krijuar me qëllim të krahasimit të % së koleksioneve në raport me popullsinë shqiptare që jeton në shtetin fqinj, Serbi, si dhe për të dëshmuar realitetin e saktë në terren. Teknika e përdorur e kërkimit është ajo e avancuar LA = kodi për kërkim sipas gjuhës dhe kodin përkatës të gjuhës së tekstit, p.sh. LA = "SCC" dhe LA= "ALB". Këto të dhëna janë bazuar sipas datës 22 maj 2010.

Tabela 2: Titujt sipas ndarjes gjuhësore në bibliotekën Kombëtare të Serbisë

Emri i bibliotekës:	**Biblioteka Nacionale e Serbisë me një total 772.333 njësi**		
Nr.	**Kodi gjuhësor**	**Nr. i titujve**	**Titujt në përqindje (%)**
1.	Scc (Serbian)	540989	70.05%
2.	Alb (Albanian)	2042	0.26%

Tabela 3: Titujt në bazë të përbërjes së gjuhës të ndërtuara në një bibliografike të përbashkët / në bazën e të dhënave të Serbisë

Emri i bibliotekës:	**Biblioteka Nacionale e Serbisë me një total 772.333 njësi**		
Nr.	**Kodi gjuhësor**	**Nr. i titujve**	**Titujt në përqindje (%)**
1.	Scc (Serbian)	540989	70.05%
2.	Alb (Albanian)	2042	0.26%

Popullsia me origjinë shqiptare që jeton në Serbi është 0.85% (Republika Srbija, Republi ki zavod za statistiku, 2003). Statistikat e paraqitura më lart të materialeve të përpunuara në gjuhën shqipe gjenden në Bibliotekën Kombëtare të Serbisë dhe në Katalogun virtual të këtij shteti (0.26% dhe 0.34%, respektivisht) nuk paraqesin ndonjë proporcion të përafërt të materialit bibliotekar sipas gjuhës me grupin etnik shqiptarë që jeton në Serbi. Kështu që diskriminimi etnik dhe politik që u bëhet shqiptarëve që jetojnë në Serbi përcillet edhe në politikat e institucioneve kulturore, d.m.th. të bibliotekave.

ZHVILLIMET E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS NË DEKADËN E FUNDIT

Historisë së vuajtur të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, me gjithë ndërrimet e emrit të saj për shkak të rrethanave ndryshuese politike në vend, represionit të ushtruara prej masave të dhunshme të viteve 1990-1999, spastrimit të koleksioneve të saja, ndjekjen e politikave të njëanshme të pasurimit të koleksioneve të saj në atë periudhë, i vjen fundi së bashku me fitimin e lirisë së popullit të Kosovës në vitin 1999. Kështu, prej këtij viti e deri më sot, ky institucion hyn në fazën e zhvillimit të tij të drejtë, me mision të qartë të mbledhjes, organizimit, shërbimit dhe ruajtjes së trashëgimisë intelektuale të dokumentuar të territorit të Kosovës.

Në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë së saj në dekadën e fundit, Biblioteka Kombëtare dhe Univer-

[3]Katalogu i Bibliotekës Kombëtare të Serbisë, zgjedh National Library of Serbia after entering the following URL: http://www.vbs.rs/scripts/cobiss?ukaz=CHDB&id=1018039039246048

[4]Katalogu i përbashkët i bibliotekave të Serbisë, zgjidh the union bibliographic/catalogue database after you enter the following URL: http://www.vbs.rs/scripts/cobiss?ukaz=CHDB&id=1018039039246048

sitare e Kosovës ka themeluar një varg mini-bibliotekash për t'iu ofruar lexuesve shërbime sa më të mira, si: Biblioteka e Këndit Amerikan, Biblioteka e Artit Bashkëkohor, Biblioteka e NATO-s, Biblioteka Muzikore, Biblioteka Europiane, Biblioteka legatë e Fehmi Aganit, Biblioteka legatë e Krist Malokit, si dhe Qendrën dokumentare "Kujtesa e Kosovës". Këto mini-biblioteka me fondet e tyre të pasura janë dhuratë nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, si dhe nga individë, kështu që koleksionet e tyre të shumëllojshme, të cilat janë në gjuhë të mëdha të botës, ofrojnë informacione me interes për përdoruesit dhe specialistët e fushave të veçanta.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare është bashkëthemeluese e dy manifestimeve të rëndësishme kulturore për librin dhe bibliotekat. Manifestimi e përvitshëm "Java e Bibliotekës në Kosovë", i themeluar bashkë me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë në vitin 2003 me qëllim të grumbullimit të bibliotekarëve nga vende të ndryshme dhe të afirmimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe zhvillimeve bibliotekare në vend dhe rajon. Ky manifestim mbahet çdo vit në muajin prill. Manifestimi i dytë është "Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë", i themeluar bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në vitin 2006, është, gjithsesi, treguesi tjetër i rëndësisë së veçantë shkencore në zhvillimin e bibliotekarisë së Shqipërisë dhe Kosovës në shumë drejtime. Konferenca Kombëtare e Bibliotekononisë mbahet çdo vit, në gjysmën e dytë të muajit nëntor.

BKUK që nga viti 2004 e boton revistën profesionale "Biblioletra". Kjo revistë sjell informacionin më të plotë për zhvillimin e BKUK-së , si dhe të bibliotekarisë së Kosovës në përgjithësi. Kjo revistë, gjithsesi, është bërë tribunë e mendimit të ekspertëve për afirmimin e bibliotekarisë së Kosovës dhe të përvojës së tyre në këtë drejtim. Gjithashtu, në fushën e botimeve, BKUK deri më tani ka botuar mbi 60 libra e botime tjera të ndryshme profesionale, origjinale dhe të përkthyera, dhe në këtë drejtim është ofruar dija më e avancuar në shkencat e bibliotekarisë bashkëkohore[5].

Në vitin 2004 Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka blerë programin e automatizuar Aleph500, produkt i kompanisë ExLibris, për automatizimin e shërbimeve bibliotekare. Tash, shumica e shërbimeve të Bibliotekës si për përdorues, ashtu edhe për personel mbështeten në platformën e këtij programi.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, BKUK, përveç se është njëra ndër themelueset e Unionit të Bibliotekave të Ballkanit në vitin 2009 në Edirne të Turqisë, është anëtare e organizatave të ndryshme në nivel ndërkombëtar. BKUK është anëtare e agjencisë së ISBN-së për botimet e librit në Kosovë, agjencisë së ISMN-së për botimet muzikore në Kosovë, pastaj anëtare e eIFL.net. Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë biblioteka kombëtare, institucione, kulturore, shkencore, arsimore etj. Ka bashkëpunim me Bibliotekën e Kongresit në SHBA, pastaj me biblioteka të ndryshme në Francë, Zvicër, Poloni, Rumani, Gjermani, Turqi, Angli, Kroaci, Maqedoni, po ashtu edhe me biblioteka të tjera të rajonit të Ballkanit. Që prej gushtit të vitit 2009 BKUK është anëtare e rregullt e Konferencës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Botës.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe e gjithë bashkësia bibliotekare në Kosovë, synojnë anëtarësimin e tyre edhe në institucionin më të lartë bibliotekar botëror në IFLA.

PËRFUNDIM

Bibliotekat publike të Kosovës kishin një zhvillim të çrregullt në historinë e tyre, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Madje, ky fenomen u theksua edhe më shumë në periudhën e viteve 90-ta të shekullit të kaluar me instalimin e masave të dhunshme në biblioteka. Ky aparat i dhunës shtetërore të regjimit serb ishte instaluar në të gjitha institucionet publike të Kosovës. Përveç, zhvillimit të njëanshëm të koleksioneve në këtë periudhë në bibliotekat e Kosovës, shumë prej tyre u dogjën tërësisht në luftën e vitit 1998/1999, e shumë prej tyre iu shkatërruan dhe iu asgjësuan koleksionet, përfshirë edhe infrastrukturën e tyre.

Në këtë kumtesë janë dhënë fakte e informacione, sipas burimeve vendore e ndërkombëtare, lidhur me zhvillimin e bibliotekave të Kosovës, si dhe në mënyrë të veçantë është dhënë një përshkrim më i gjerë i zhvillimeve në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës pasi për të lidhet edhe vet shkrimi i historisë së popullit të Kosovës, me gjithë ato ndërrime

[5]Shih botimet e BKUK-së në URL: http://www.biblioteka-ks.org/Veprimtaria_botuese.php

emrash që pësoi në një historinë e saj afro një gjysmëshekulli të ekzistencës së saj. Pas çlirimit të vendit, në vitin 1999, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, por edhe bibliotekat e tjera në Kosovë, u orientuan drejt zhvillimit dhe përmbushjes së mirëfilltë të misionit të tyre duke i respektuar të gjitha obligimet kushtetuese të Republikës së Kosovës drejt respektimit të të drejtave të secilës pakicë etnike të vendit. Për këtë arsye janë dhënë një mori faktesh e statistikash lidhur me përpunimin e koleksioneve, veçanërisht, në gjuhën serbe për të mohuar një herë e përgjithmonë zërat se gjoja nuk u ruhen dhe përpunohen koleksionet në gjuhët tjera.

Në fund, dëshirojmë të vëmë në dukje se Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si institucioni qendror i bibliotekarisë në vend, është gjithnjë e gatshme për bashkëpunim konstruktiv të çfarëdo natyre, por duke mos hezituar t'i kundërpërgjigjet çdo të pavërtete që lëshohet kundër saj apo bibliotekave të vendit. Krejt në fund, duke pasur parasysh ritmin e zhvillimeve politike brenda vendit dhe në nivel ndërkombëtar shpresojmë se së shpejti të përmbushen parakushtet teknike dhe politike të anëtarësimit me të drejta të plota të bashkësisë bibliotekare kosovare në IFLA.

REFERENCA

- BKUK, Raporti nr. 11. (05.01.2006). Raport lidhur me dëmet e shkatuara në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në periudhën 1990-1999. (Arkivi i BKUK-së).
- Bylykbashi, I. (1996). ... 555 ... [Pesqind e pesëdhjetë e pesë ...]: kronikë (1981-1995). Prishtinë: Rilindja.
- Dokumenti i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Serbisë nr. 630-02-32/99-34, 1999. Beograd. (Arkivi i BKUK-së) .
- Enti i Statistikave të Kosovës (n.d.). Indikatorë demografik. Retrieved May 18, 2010, from http://www.ks-gov.net/esk
- Enti i Statistikës së Kosovës. (2008). Informata gjeografike për Kosovën. Retrieved May 20, 2010, from http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_content&view=article&id=58&Itemid=45
- Frederiksen, C. & Bakken, F. (2000). Libraries in Kosova/Kosovo: A general assessmentand a short and medium-term development plan (IFLA/FAIFE REPORT / APRIL 2000). Retrieved May 15, 2010, from http://archive.ifla.org/faife/faife/kosova/kosorepo.htm
- Gjenocidi serb ndaj librit shqip në Kosovë 1998/1999. (2000). (Arkivi i BKUK-së).
- Herscher, A. & Riedlmayer, A. (2001). The destruction of cultural heritage in Kosovo, 1998-1999: a post-war survey. (Filed at the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia on 28 Februrary 2002). Retrieved May 19, 2010, from http://hague.bard.edu/reports/hr_riedlmayer-28feb2002.pdf
- Hoddinott, R. F. (1963). Early Byzantine churches in Macedonia and Southern Serbia: a study of the origins and the initial development of East Christian art. London: Macmillan, pp. 200-202.
- Republika Srbija, Republi ki zavod za statistiku. (2003). Stanovništvo (Popis stanovništva, doma instava i stanova u 2002). Beograd. Retrieved May 21, 2010, from http://webrzs.stat.gov.rs/axd/Zip/VJN3.pdf
- Riedlmayer, A, J. (2007). Crimes of war, crimes of peace: destruction of libraries during and after the Balkan wars of the 1990s. Library Trends, 56 (1), 107-132. Retrieved May 21, 2010, from http://www.ideals.illinois.edu/bitstream/handle/2142/3784/Riedlmayer561.pdf?
Leximi studimor, ndërkaq, sjell disa veçori që duhet marrë në konsideratë. Duke qenë se bëhet fjalë për studime themelore dhe jo për studime të thelluara, këtij synimi të lexuesit i përshtatet edhe natyra e librave që kërkohen. Në rend të parë këtu bëjnë pjesë librat me studime historiko-letrare dhe përgjithësisht librat që kanë karakterin e teksteve universitare, ndonëse shpesh nuk janë emërtuar si të tillë. Shikuar nga ky aspekt, është e natyrshme që autorët e traditës të konsumohen më shumë se autorët e letërsisë bashkëkohore. Më pas vijnë studimet teorike dhe librat me shkrime kritike dhe analiza letrare të autorëve dhe të veprave të caktuara. Nga librat me studime teorike, bie në sy edhe një numër autorësh të huaj, të cilët tashmë janë përkthyer në shqip. Shfrytëzues të kësaj literature kryesisht janë lexuesit që ndjekin studimet për master, ndërsa lexuesit e studimeve të rregullta mjaftohen me literaturën e autorëve shqiptarë.

Duhet përmendur këtu edhe një fenomen tjetër, i cili është dukshëm i përhapur te ne: studenti, kandidati për studimet master, njësoj sikundër edhe kandidati për doktoraturë, e ka pothuajse të domosdoshme të lexojë librat e profesorit të vet. Prandaj, autorët shqiptarë më të lexuar nga fusha e studimeve letrare në përgjithësi janë ata që njëkohësisht janë edhe profesorë në katedrat e letërsisë.

PËRFUNDIM

Leximi i letërsisë dhe konsumimi i saj në bibliotekë është një fenomen kompleks, që varet nga shumë faktorë: nga faktorët socialë, edukativo-arsimor dhe kulturor. Një studim i këtij fenomeni besoj se do të nxirrte përfundime më interes nga sociologjia e letërsisë, të cilat, ndër të tjera, përfshijnë edhe praktikat tona të nxënies dhe studimit të letërsisë, njësoj sikundër edhe fenomenin social-kulturor të leximit, respektivisht të mosleximit të letërsisë te ne.

TAVOLINA REFERALE - NJOHJA ME BIBLIOTEKËN

JEHONA SHALA

Duke mos synuar anashkalimin e datave kryesore që lidhen direkt me këtë institucion, si ato 1944-‘52, 1956-‘61, 1961-‘70, 1990-’99, si dhe data nga ’99 e deri me sot, që kanë të bëjnë në fillim me themelimin dhe me pastaj me zhvillimin e këtij institucioni, po orientohemi nga një shërbim që ky institucion ka bërë dikur e që vazhdon ta bëjë dhe sot, atë të shërbimit ndaj lexuesit.

Një bibliotekë pa këtë shërbim do të ngjasonte në një deponi librash, prandaj kushtimi i një kujdesi të veçantë ndaj këtij shërbimi do ta bënte një bibliotekë e çfarëdo lloji qoftë ajo, më pak ose më shumë të suksesshme.

Informacioni që ky institucion pavarësisht lokacionit se ku ka ekzistuar dhe është gjendur me kalimin e kohës tregon se ka qëndruar i tillë në më së paku për dy arsye: (1) grumbullimin e librit, materialit bibliotekar në përgjithësi dhe (2) shpërndarjen e tij te lexuesi.

Në këtë pikë duhet theksuar se njëra nga shërbimet që ofron ky institucion dhe që është pika kyçe e kontaktit me lexuesin/përdoruesin është Departamenti i Informacioneve dhe i Shërbimeve Bibliotekare, i përbërë nga katër shërbime: Shërbimi i Informacionit, Shërbimi i Përdoruesve, Shërbimi i Koleksioneve të Deponuara dhe Qendra e Internetit.

Nëse i vendosim këto shërbime nëpër vitet e lartpërmendura ose me saktë në vitet e fillimit të punës së këtij institucioni, pjesa e katërt përbërëse e këtij shërbimi domosdo se nuk do të ekzistonte. Por, është mëse e qartë se me kalimin e viteve ky institucion ka punuar dhe vepruar duke u zhvilluar më tutje konform disa modeleve, respektivisht konform disa normave që bëhen te obligueshme nga vetë koha. Dhe, është pikërisht koha ajo që sot na e tregon rëndësinë qe ka secili prej shërbimeve të këtij departamenti në përgjithësi, por në veçanti Shërbimi i Informacionit. Ku si rrjedhojë, ky shërbim sot vazhdon të jetë hapësira me e frekuentuar nga lexuesi meqë është hapi i parë i secilit lexues që ka nevojë për udhëzime, informata, informacion për skedarët alfabetikë, sistematikë, tipografikë e të periodikut që kanë qenë shumë të përdorshëm dikur, si dhe informacion rreth hulumtimit në bazën e të dhënave të bibliotekës, që ekziston sot.

Zhvillimi i punës me zgjedhjen e modeleve me të mira për shërbim ndaj lexuesit dhe ofrimin e informacionit sa me të mirë ose të nevojshëm për lexuesin na zhvendos një hap me tutje dhe gjithashtu na e obligon zgjedhjen e një modeli të përdorshëm dhe funksional që ekziston në bibliotekat më të njohura në botë. Një model i nxjerrë nga bibliotekat e zhvilluara e që do të mund të bëhej pjese e këtij departamenti, ose të shkrinte brenda tij disa nga shërbimet, do të ishte zgjedhja e modelit të shërbimit referal, ose tavolina referale, krijimi ose zgjerimi i së cilës do të shkonte përtej një informacioni që mund të ofrojë Shërbimi i Informacionit, për të krijuar kështu një hapësirë të plotësuar me bibliotekarin ose bibliotekarët e përgatitur me njohje të mira, në radhë të par me njohuri të përgjithshme kulturore e më pastaj me njohuri të mirë mbi fondin e bibliotekës, pavarësisht departamenteve në të cilat mund të jenë të ndara materialet bibliotekare.

Në këtë mënyrë, tavolina referale do të krijonte lehtësi për të gjithë llojet e përdoruesve, qofshin ata studentë që hyjnë në bibliotekë me ide të qartë se çfarë kërkojnë për lexim, qofshin ata lexues të rinj që vijnë në bibliotekë për të lexuar "diçka argëtuese", qofshin ata të moshuar që ndjejnë si nevojë të "rishohin" kohën e tyre, duke kërkuar të gjurmojnë nëpër periodikë të ndryshëm, ose qofshin ata lexues të X profesioni që hyjnë në një bibliotekë, duke e parë atë si një vend ku mund të gjejnë ndonjë libër që u nevojitet vetëm si "pushim" ose ikje për një kohë nga puna e përditshme.

Të gjithë tipat e lexuesve do ta ndjenin si nevojë të zhvillonin kontaktin me tavolinën referale, ngjashëm sikurse personeli në tavolinën referale do ta ndjente si obligim ofrimin e shërbimit dhe informacionit plotësues ndaj këtyre përdoruesve, duke shkuar kështu përtej një informacioni të thjeshtë, gjithashtu duke u mundësuar lexuesve njohje më të thella me materialet bibliotekare.

Me këtë rast, nëse shtrojmë pyetjet se sa lexues e dinë se brenda një biblioteke kombëtare mund edhe të dëgjojnë këngë nga folklori? Ose sa dinë se gjithashtu brenda një biblioteke kombëtare mund të gjenden doreshkrime të vlefshme për kulturën e atij kombi? Ose sa lexues e dinë se sa burime elektronike ka sot Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës?

Përgjigja se sa, nuk është e sigurt, por ajo që është mëse e sigurt është se shërbimi i tavolinës referale i kompletuar me bibliotekarët e mirëinformuar do të bënte me shumë se dhënien e një informacioni të thjeshtë si ky, ose edhe do t'ia bënte të njohur lexuesit vlerat kulturore e shkencore që përmban një bibliotekë kombëtare dhe universitare siç është BKUK-ja.



Ky shërbim do të krijonte të gjitha parakushtet që lexuesi jo vetëm të ketë këto informacione, por përmes kësaj do të përcillte te lexuesi/përdoruesi gjithë kujtesën historike te një vendi në këtë rast të Kosovës që është e që duhet të jetë brenda Bibliotekës Kombëtare dhe po ashtu gjithë informacionin mbi zhvillimet me të reja të shkencës dhe teknologjisë që mund e që duhet të gjendet brenda Bibliotekës Universitare.

Dhe, krahas kësaj, përpos një shërbimi të thjeshtë ndaj lexuesit, do të krijohej një shans i mirë edhe për orientimin drejt teksteve ose materialeve bibliotekare të vlefshme për formimin e një lexuesi të ri, ose për krijimin e kushteve "komode" për të "ngjallur të kaluarën" për një lexues të moshuar.

Kështu që, krijimi i mundësisë së zhvillimit të punës në bibliotekën tonë, krahas zhvillimeve që ngjajnë në bibliotekat në botën e zhvilluar, do të hapte rrugë drejt mundësisë së krijimit dhe shënimit të një date, që do të bëhej pjesë e datave të rëndësishme të këtij institucioni, duke shënuar në këtë mënyrë krijimin e një shërbimi ideal që duhet t'i ofrohet lexuesit dhe transparencën ideale që një bibliotekë, pothuajse e "mbyllur" deri me sot, do ta bënte për përdoruesin e saj.

LITERATURA:

- Rosenberg , Ida L., "Problems of e Reference Librarian", Library Jurnal, Qershor, 1991 (www.ebscohost.com, Database: MasterFILE Premier);
- Katz, William A., "Hyrje në punën e referencave: Shërbimet themelore informative", V.1, BKUK, Prishtinë, 2007;
- Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës: 60 vjet, BKUK, Prishtinë, 2004;
- Oberembt, Keneth J., "Plani strategjik pwr Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare", U.S. Oficce Pristina dhe BKUK, Prishtinë 2004;
- Java e Bibliotekës në Kosovë: 3-8 prill 2006, BKUK, Prishtinë, 2007;
- Gangl, Susan, "The Librarian's Library: Fugitive Reference Files", Reference Librarian; 2001, Vol. 34 (www.ebscohost.com).

BKUK – NEVOJA PËR KRIJIMIN E BIBLIOTEKËS DIGJITALE

BERAT ARMAGEDONI

Për të arritur perspektivat e zhvillimit të sotëm dhe të ardhshëm bibliotekar, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës duhet të nisë të punojë në projektin për digjitalizimin e koleksioneve, fillimisht të materialeve bibliotekare të dekadës së fundit, për të vijuar më pastaj me digjitalizimin gjithëpërfshirës të koleksioneve.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, bibliotekat e fakulteteve, bibliotekat ndërkomunale dhe ato në institucionet shkollore të shkollimi fillor e të mesëm, të shkollave publike e private, etj., duhet të mundësojnë aplikimin e teknologjisë më të re të informacionit, për arsye se tashmë kjo teknologji, sidomos interneti, e ka ndryshuar dhe po e ndryshon komunikimin e shoqërisë, kulturën e saj.

Punën me dorë po e zëvendëson puna me kompjuter, i cili, përpos që po ndihmon të kryhet puna më mirë dhe më shpejt, po shkurton edhe numrin e punëtorëve nga ç'kërkoheshin më parë për të kryer një projekt. Për ta ilustruar këtë punë kaq të mundimshme e të gjatë të punës me dorë të punonjësve, p.sh, punës me dorë të skedave, ta marrim një shembull konkret e të tashëm nga Departamenti i Bibliografisë i BKUK-së, e cila që sa kohë, mbase 20 vjet, ka nisur ta përgatisë një bibliografi të librit shqip në Kosovë (1944-1984), por që, deri më sot, fatkeqësisht, është punuar shumë e, fatmirësisht, shumë shpejt, pas kaq kohësh, po sheh ditën e botimit ai libër me mbi 8 000 njësi bibliografike.

Ky projekt për hartimin e kësaj bibliografie dikur ka marrë kohë shumë, sepse nuk ka qenë i lehtë për t'u përgatitur. Udhëheqësi i saj dhe hartuesit e saj, kur kanë nisur ta daktilografojnë gjithë atë material bibliografik (të viteve 1944-1984) në ëord, janë përballur me skeda të shkruara si mos më keq nga mos më shumë se 20 duar të njerëzve punuar në to mbi 20 vjet. Por, me shumë mund ia kanë arritur që punën 20-vjeçare të nisur ta përmbyllin shumë shpejt me ndihmën e kompjuterit dhe, natyrisht, me përvojat e tyre të shumta si bibliografë. Ama kjo e mirë ka edhe një të keqe.

Ky mund i tyre mund të harrohet ose të bie rrallë ndërmend po qe se kjo bibliografi nuk digjitalizohet. Ajo nuk duhet të mbetet vetëm në format të librit. Sot duhet të bëhet digjitalizimi i saj, sikurse bibliografitë e librat në bibliotekat evropiane e botërore. Nëse ajo ka vlerë tash si libër i botuar (në dy pjesë), shumë më me vlerë do të kishte nëse në uebfaqen e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës do të mund të lexohej nga ata përdorues që janë të interesuar për këtë lloj informacioni bibliografik, siç mund të jenë të interesuar edhe për lloje të tjera të informacionit e te materialit bibliotekar.

Kushtet për t'u realizuar ky digjitalizim deri-diku janë. Duhen edhe pak mjete teknike. Biblioteka ka

pajisje për skanimin e dokumenteve, ashtu siç e ka edhe uebfaqen për t'i prezantuar librat në dekadën e fundit të këtij shekulli. Ka edhe teknikë të teknologjisë informative të mirë dhe të mjaftueshëm. Megjithatë, vetëm digjitalizimi i bibliografisë është pak. Duhet një projekt i madh.

BKUK duhet të hartojë një projekt, i cili do të ndahej në faza të caktuara, për mundësinë e digjitalizimit të koleksioneve. Paralelisht me digjitalizimin e koleksioneve të veta, të bashkëpunojë në kuptimin institucional e ligjor, me autorë e botues të cilët kanë në dispozicion botime e tyre përkatëse në kopje elektronike, të cilat mund t'ia ofrojnë BKUK-së. Do të ishte punë shumë e lakmueshme dhe e përmendur, ngaqë me këtë rast do të përfitonin: autori i atij libri/vepre/teksti, biblioteka, por edhe lexuesit. Dhe kjo nuk është punë shumë e vështirë që të realizohet. Sot gjithë librat shkruhen në programe të kompjuterit, veçanërisht në ëord, materiali i të cilit mund të transferohet edhe në PDF e derivate të programeve të tjera për t'u bërë më i lehtë i lexueshëm e i shfletueshëm.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka bërë diçka. S'duhet të harrojmë se ajo rrjetin e vet të programit shumë të avancuar digjital, Aleph 500, e ka shtrirë nëpër disa biblioteka ndërkomunale, mirëpo ai mundëson vetëm gjetjen e titujve të librave që gjenden në depot e saj ose në ndonjërin departament të saj. Ani pse ka bërë këtë hap kaq me rëndësi, i cili kërkuesve të literaturës u ka mundësuar t'i ikin katalogut manual e t'i gjejnë librat e nevojshëm më lehtë nga shtëpia ose nga vendi i punës ku punojnë, ende nuk ka bërë asgjë rreth digjitalizimit të librave në uebfaqen e saj ëëë.biblioteka-ks.org të atyre teksteve: punimeve të masterit e të doktoraturës, librave e vepra të ndryshme, të cilat i përmendëm më lart, e të cilat dorëzohen si kopje të detyrueshme, në formate të ndryshme, (A4, A5, A3), në Departamentin e Pasurimit. Kohët e fundit atyre iu bashkëngjitet edhe cd-ja e mbushur me material. Mendim i mirë, shumë i arsyeshëm dhe punë e lehtë për punonjësit e BKUK-së për ta futur atë material të cd-së në uebfaqen e bibliotekës. Pra, do të ishte mirë që të ndërtohet një infrastrukturë ligjore që do të mundësonte që arkivat e fakulteteve, autorët, shtëpitë botuese, të gjithë ata që kanë tekste të shkruara (punime masteri e doktoratura) e të botuara (libra e revista) t'ia japin BKUK-së në cd apo suporte të tjera elektronike.

Duhet të kuptojmë se biblioteka nuk është vend vetëm ku ruhet libri, por është vend edhe ku mund të shërbehesh me libra e duhet edhe të shërbehesh me dokumentacione elektronike nga çdo vend.

Statistikat tregojnë se sot edhe në shumë zona rurale është shtrirë rrjeti i internetit, se shumë individë kanë kompjuterë e internet në shtëpi, nga të cilët mund të bëjnë kërkimin. Kjo punë nuk paraqet problem as për shtëpitë botuese, as për autorët e as për fakultetet, përpos, natyrisht, lehtësim dhe komunikim të tyre me përdoruesin.

Nëse ndonjëherë bëhet kështu siç mendojmë, teknikët e teknologjisë informative, të cilët dinë të bëjnë punë edhe në dizajn, duhet ta ridizajnojnë edhe uebfaqen e bibliotekës, në të cilën do të mund të shtonin edhe disa fusha e nënfusha për materialet (librat) që digjitalizohen e, pse jo, edhe të dizajnohen me logo të BKUK-së.

Me më rëndësi se gazetat e revistat, duhet të digjitalizohen librat, për arsye se disa gazeta të përditshme në Kosovë kanë nisur ta mirëmbajnë edhe uebfaqen e gazetës së tyre, si: www.gazetaexpress.com, www.botasot.com, www.zëri.com e ndonjë tjetër e të cilat mund të ofrohen si linçe në uebfaqen e BKUK-së.

Për ta tubuar dijen diku e për ta shfrytëzuar sa më lehtë, më kujtohet një ese e publicistit Artan Fuga, "Arsimi në epokën e internetit", i cili në të veçon: "Çdo epokë e qytetërimeve të ndryshme në historinë e tyre ka pasur një agjenci të madhe ku është përqendruar informacioni. Në periudhat primitive këta ishin pleqtë e fisit. Në periudhën e Mesjetës së hershme dhe të mesme këta ishin skribët që jo vetëm bartnin në memorien e tyre të gjallë kolektive dijet e epokës, sado të veshura me vello fetare, por edhe e hidhnin këtë dije në tekste monumentale që qarkullonin në duart e elitave të asaj kohe. Më pas, ishte Kisha që zotëronte monopolin e dijes, e cila pas një kohe u rivalizua nga universitetet, të cilat në konkurrencë ideologjike me të, u bënë qendrat më të rëndësishme të prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit shkencor".

Duhet të nxitohet të bëhet sa më shpejt digjitalizimi i informacionit, pasi dimë se biblioteka u shërben lexuesve dhe, në këtë kontekst, ata duhet të plotësojnë mjaftueshëm interesimet e tyre gjatë kërkimit.

Sot interneti dhe teknologjitë e informimit e bëjnë më të zëshme dhe më të dobishme Bibliotekën Kombëtare dhe çdo institucion tjetër që ofron informacion. Duke vëzhguar zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe interesimin e njerëzve, shumë shpejt, pritet që bibliotekat nga afër, kudo që përdoruesi gjendet, t'i ofrojnë gjithë informacionin, tekstin – librën, revistën etj., që është pjesë e kërkimeve dinamike e të sistemuara të tij.

LIGJI PËR BIBLIOTEKAT DHE NEVOJA E RISHIKIMIT

IZET ABDYLI

Ligji për Bibliotekat nr. 2003/6 i aprovuar pas luftës nga Kuvendi i Kosovës, si një ligj bazik për bibliotekat dhe fushën e bibliotekarisë në Kosove, ishte një bazë e mirë, për funksionalizimin dhe mëkëmbjen e bibliotekave në Kosovë. Ky ligj përcaktoi parimet dhe normat themelore për veprimtarinë bibliotekare dhe për organizimin e mirëvajtjen e bibliotekave Mirëpo zhvillimi i hovshëm i bibliotekave dhe bibliotekarisë në epokën moderne dhe trendët e reja të zhvillimit të teknologjisë së informacionit, kanë hapur mundësinë dhe nevojën e përshtatjes se legjislacionit konform ecurive të këtij zhvillimi. Duhet të përmendim faktin që legjislacioni aktual nuk është shoqëruar me asnjë akt nënligjor nga ministritë përkatëse, që do të krijonte një bazë më të mirë të funksionimit të këtij ligji, Në këtë kontekst, edhe nga ky fakt, del si nevojë e domosdoshme ndryshimi i tij dhe përshtatja me rrethanat e kohës.

Pra, mungesa e nxjerrjes se akteve nënligjore nga institucionet përkatëse ka bërë që në shumë fusha ky ligj të mos implementohet dhe të mbetet në gjysmë të rrugës. Praktika ka treguar se disa nga qasjet dhe formulimet në këtë ligj, që përkojnë me disa nga segmentet dhe fushat e caktuara, si: funksionimi i këshillave të bibliotekave, çështja e ekzemplarit të detyrueshëm, mbikëqyrja administrative apo mbikëqyrja profesionale e bibliotekave publike, shkollore apo të veçanta, nuk kanë funksionuar si duhet, prandaj shtrohet nevoja e rishqyrtimit të këtij ligji, duke e pasuruar atë me më shumë akte nënligjore, që do ta bënte ligjin funksional dhe të implementueshëm jo vetëm në dimensionin që përfshin ekskluzivitetin në fushë të funksionimit të brendshëm të bibliotekave, por edhe të relacionit të bibliotekave në mes vete, sipas rëndësisë dhe llojit të tyre, të relacionit të bibliotekave me institucionet mbikëqyrëse, të bibliotekave me botuesit, si dhe të bibliotekave në nivel bashkëpunimesh e shkëmbimesh me bibliotekat ndërkombëtare.

Në kontekst të kësaj vlen të përmenden edhe ndryshimet faktike që ka bërë në hierarkinë e organizimit të sistemit bibliotekar, Ministria e Pushtetit Lokal bashkë me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me bibliotekat ndërkomunale, të cilat kanë kaluar tashmë në administrim të komunave. Kjo është bërë në kundërshtim me ligjin aktual, meqë neni. – 11.1. i ligjit për biblioteka, përcakton se: Ministria e Kulturës ushtron aktivitete të administrimit qendror lidhur me bibliotekat ndërkomunale dhe Bibliotekën e Kosovës dhe të bibliotekave që veprojnë në përbërjen e institucioneve që ka nën përgjegjësi.

Gjithashtu, procesi i ndarjes së Bibliotekës Universitare nga Biblioteka Kombëtare, që aktualisht është në proces, dhe jetësimi i nenit 3.8 të këtij ligji që e vënë MASHT-in si autoritet që ka në varësi Bibliotekën Universitare, krijon domosdonë e saktësimit të një pozicioni të ri të Bibliotekës Kombëtare, si një institucion me rëndësi në hierarkinë e institucioneve. Edhe me ligjin aktual, përkatësisht neni 22, paragrafi 22.1 dhe 22.2, Biblioteka Kombëtare përkufizohet si institucion bibliotekar qendror i Kosovës, dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kosovar dhe, po ashtu, Biblioteka Kombëtare e Kosovës themelohet me vendim të Kuvendit të Kosovës. Si rrjedhojë, ky institucion hyn në rangun e institucione me rëndësi kombëtare, siç janë: Arkivat Shtetëror, Akademia e Arteve dhe Shkencave të Republikës së Kosovës, etj.

Pra, po të lexohen me kujdes nenet dhe paragrafët e këtij ligji, shihen edhe një varg i kolizioneve në mes tyre, siç janë evidente edhe një varg lëshimesh e gabimesh teknike, e që është e domosdoshme të evitohen.

Mungesa e kuadrove profesionale në fushën e bibliotekarisë, shtron domosdonë e autorizimit ligjor të Bibliotekës Kombëtare si institucion që do të duhej të merrej me licencimin e bibliotekarëve, organizimin dhe profesionalizimin në shkallën e kualifikimit, siç e kanë bibliotekat nacionale të rajonit.

Si përfundim, nga krejt kjo që u tha më lart, ndryshimi apo amandamentimi i këtij ligji është i domosdoshëm, në mënyrë që bibliotekat në Kosovë të kenë funksionalitetin e plotë në nivel të procesit organizativ të punëve, si dhe të hierarkisë e ndarjes së përgjegjësive sipas sistemit dhe strukturave të organizimit e varësisë së institucioneve tona.

ASOCIACIONI I BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

QASJA NË BURIMET ELEKTRONIKE PËR PËRDORUESIT E KOSOVËS

BUKURIJE HALITI

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përmes Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), anëtarë të së cilës janë edhe Bibliotekat Ndërkomunale të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, si dhe disa nga kolegjet kryesore private në Kosovë, ka siguruar qasje në burime elektronike të EBSCO-s për vitin 2010.

Qasja në burimet elektronike u mundësohet të gjithë përdoruesve të BKUK-së, të Bibliotekave Ndërkomunale, të Universitetit të Prishtinës, si dhe të Kolegjeve: Victory, UBT, Pjetër Budi, Kolegji për Studime të Menaxhmentit Internacional, AAB-RIINVEST, si dhe Kolegji FAMA, të cilat kanë mundësuar, nëpërmjet parapagimit, qasje në këto burime elektronike. Pra, ky është një grup bibliotekash të bashkuara, që synon të rrisë fuqinë në sigurimin e shërbimeve elektronike.

Sigurimi i shërbimeve në burimet elektronike të EBSCO-s, si dhe në tri burime, që Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës ka arritur t'i siguroj falas - JSTOR, ALUKA dhe BioOne, përdoruesit në Kosovë do t'i japin mundësi kërkimesh hulumtuese e shkencore nga baza e të dhënave bibliografike e deri te ato me tekst të plotë, që janë sot të domosdoshme në fushën e kërkimit e të hulumtimit.

Për përdoruesit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, më parë nga donacioni i Raiffeisen Bank janë siguruar dy burime të veçanta elektronike - që janë pjesë e koleksioneve elektronike të Sektorit të Muzikës - Grove Music Online dhe Encyclopedia of Popular Music. Gjithashtu, ky Asociacion është duke negociuar për të pasur qasje edhe në burimet e Cambridge Journals.

Kosova ka pasur qasje në informacionet e të dhënave EBSCO, gjatë viteve 2002 - 2004, fillimisht donacion nga fondacioni SOROS në Prishtinë. Gjatë viteve 2007-2009, Ambasada Amerikane në Prishtinë ka siguruat, nëpërmjet një donacionin, shërbime nga baza e të dhënave EBSCO dhe GALE, ndërsa që gjatë vitit 2008, OSBE-ja ka siguruar shërbime për anëtarëve të Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, shërbime në burimet elektronike: OXFORD JOURNALS dhe OXFORD SCHOLARSHIP ONLINE.

Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, është i anëtarësuar në eIFL, e cila vendeve në tranzicion u lejon qasje të barabartë dhe me çmim të ulët blerës ose falas në burimet elektronike. Ky Asociacion, përveç se negocion dhe siguron qasje në burimet elektronike, gjithashtu, bën aftësimin e bibliotekarëve dhe përdoruesve në kërkime në këto burime, si dhe jep këshilla dhe udhëzime për anëtarët e këtij Asociacioni.

Për të gjithë përdoruesit, që kërkimin e tyre e bëjnë në biblioteka të Kosovës, Universitetin e Prishtinës, si dhe në kolegjet e lartpërmendura private, kanë mundësi që nëpërmjet shërbimeve të EBSCO-së, të kenë qasje në një numër të madh të bazave të dhënave bibliografike dhe me tekst të plotë, të cilat plotësojnë nevojat për informacion të të gjitha llojeve të bibliotekave kudo në botë.

EBSCO ka publikime dhe shërbime të specializuara për biblioteka universitare, mjekësore, qeveritare, shkollore dhe publike, si dhe për institucione dhe gazeta. Duke përbërë një bazë të të dhënave me mëse 60.000 botues kudo në botë. Ajo i shërben komunitetit bibliotekar dhe biznesit që nga viti 1944.

Ndërsa JSTOR ka krijuar një arkiv të kualitetit të lartë dhe arkivave ndërdisiplinore të bursave, ka ruajtur në mënyrë aktive mbi një mijë revista akademike në dy formate - atë digjitale dhe të shtypura, dhe vazhdon të zgjerohet në masë të madhe në qasje të veprave shkencore dhe materialeve të tjera nevojshme për hulumtim dhe mësimdhënie në nivel global.

Ashtu si JSTOR edhe BioOne ofron shërbime në burimet elektronike në fusha të ndryshme te shkencave biologjike dhe ALUKA në fusha të ndryshme siç janë arkeologjia, historia, botanika, gjeografia, etj.

Dy burime të veçanta elektronike i janë shtuar koleksioneve elektronike të Sektorit të Muzikës në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: Grove Music Online dhe Encyclopedia of Popular Music. Të dy këto burime u dedikohen në radhë të pare lexuesve e përdoruesve të profilit

muzikor, e më pas edhe përdoruesve të interesuar të profileve të tjera.

Grove Music Online është burim elektronik më autoritativ në të gjitha aspektet në fushën e muzikës. Ky burim përfshinë 50 000 artikuj dhe 28 000 biografi në të cilat kanë kontribuar mbi 6 000 studiues nga e mbarë bota. Abonimi në Grove Music Online përfshin edhe Oxford Companion to Music (20020, i cili ofron më shumë se 8 000 artikuj për kompozitorë, dirigjentë, interpretues, vepra individuale, instrumente, forma dhe zhanre muzikore.

The Oxford Dictionary of Music (2006), është burim elektronik që jep informacione më të gjëra në fushën e muzikës, duke i plotësuar nevojat kryesisht të studentëve në studimet themelore si dhe të përdoruesit të interesuar. Encyclopedia of Popular Music - i botuar në 10 vëllime, tashmë ofrohet në formë elektronike përmes internetit edhe në BKUK. Ky burim ka 27 000 zëra, të cilët mbulojnë tema nga muzika popullore e të gjitha zhanreve të periudhës prej vitit 1900 deri më sot. Jepen po ashtu edhe data të rëndësishme, biografi dhe informacione më të gjera për artistët të përfshirë në këtë enciklopedi së bashku me një diskografi të kompletuar që përfshin etiketat e incizimeve, datën e botimit, si dhe një sistem të rangimit me 5 yje të albumeve të tyre.

Që nga gushti i këtij viti ABEK (Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës) ka nënshkruar marrëveshjen për të pasur qasje për tri vite, do të thotë deri me 2010 në 235 tituj të revistave elektronike të Cambridge Journals. Kjo bazë e të dhënave mbulon fusha të ndryshme të shkencës si: shkencat shoqërore, shkencat e aplikuara, mjedisi dhe

konservimi, pastaj bujqësia, biomedicina, historia, gjuhësia dhe letërsia, shkencat politike dhe ndërkombëtare etj.

Bazë tjetër e të dhënave që është siguruar për tri vite e që përdoruesit mund të kenë qasje është edhe Oxford English Dictionary Online, burim ky shumë i vlefshëm për hulumtim në fusha të ndryshme. Siguron definicione të mbi gjysmë milioni fjalësh. Po ashtu ofron informacione të specifike të fjalës në kohë dhe periudhë të caktuar të historisë dhe si ka ndryshuar gjatë periudhave të ndryshme.

Oxford Reference Online ofron qasje në kërkimet me tekst të plotë të mbi 200 fjalorëve dhe librave referalë të shkruar nga ekspertë dhe akademikë të njohur, e botuar nga Oxford University Press. Përfshin mëse 1.5 milionë të dhëna nga përkufizimet e sakta për referencë, për artikuj, dhe gjithashtu mbi 16.000 fotografi dhe një numër të karakteristikave të tjera të veçanta. Përfshin fjalorët anglisht, fjalorë dygjuhësh dhe gjithashtu enciklopedi. Ofron po ashtu edhe fjalorë dhe vepra referale të fushave të veçanta si në art dhe arkitekturë, shkencat biologjike, informatika, ambienti, gjuha angleze, ushqimi, historia dhe ligji, mjekësia, letërsia e të tjera.

JSTOR, BIOONE, ALUKA, CAMBRIDGE JOURNALS, OXFORD ENGLISH DICTIONARY ONLINE, OXOFORD REFERNCE ONLINE kanë nënshkruar marrëveshje me ABEK-un, i cili do t'u sigurojë qasje në këto burime, përdoruesve që janë anëtarë të institucioneve përkatëse - bibliotekave dhe kolegjeve të lartpërmendura, edhe për tri vitet e ardhshme.

DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT DHE E TË DREJTËS SË AUTORIT

Prishtinë, 23 prill 2010,

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, më 23 prill 2010, organizoi manifestim kulturor me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit.

Kjo ngjarje kulturore, si ditë kujtimi që promovon leximin, botimin dhe mbrojtjen e pronës intelektuale, mblodhi dashamirësit e librit e të kulturës në BKUK.

Në fjalën e hapjes së këtij manifestimi, drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - dr. Sali Bashota, theksoi rëndësinë e kësaj dite, si ditë që ka simbolikën e vet të festimit e të promovimit të librit e të mbrojtjes së të drejtës se autorit, si ditë ku edhe ne këtu në Kosovë reflektojmë se si të afirmojmë leximin e të avancojmë dijen dhe kontributin për bibliotekat dhe librin.

Ndërsa, shkrimtari dhe botuesi Nazmi Rrahmani ka folur për nevojën e përkrahjes së leximit e të botimit të librit dhe ndikimin e tij në një shoqëri demokratike, duke iu bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të punojnë më shumë në përkrahje të botimit e të qarkullimit të librit.

Dhurohen libra për Ditën Ndërkombëtare të Librit

Më rastin shënimit të këtij përvjetori, BKUK ka dhuruar simbolikisht 99 libra për nxënës të shkollave fillore, të mesme, studentë, krijues dhe punonjës të bibliotekës.

Po ashtu, me rastin e kësaj dite, u dhuruan libra për bibliotekën e shkollës fillore "Naim Frashëri" të Prishtinës, si dhe u promovua hapja e bibliotekës së shkollës fillore "Dituria" të fshatit Shkabaj të Obiliqit - si ide e projektit të iniciuar para tri vitesh nga BKUK dhe botuesit e Kosovë, për themelimin e nga një biblioteke të re në Kosovë, çdo vit - me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit, ku botuesit, institucionet dhe individë, do të dhurojnë botimet e tyre për të ndihmuar formimin e një biblioteke në Kosovë.

Në këtë manifestim, në nderim të kësaj dite, janë lexuar vargje nga poezia e poetëve shqiptarë Naim Frashëri dhe Esad Mekuli, nga punëtorët e BKUK-së - Flamur Maloku dhe Flora Mazreku, ndërsa nga Arta Buzhala janë lexuar pjesë nga veprat e shkrimtarit të madh anglez William Shakespeare.

Durim Hasaj

PËRUROHET QENDRA E TRAJNIMEVE - INVESTIM I PROCREDIT BANK-ës

Prishtinë, 4 maj 2010

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, më 4 maj 2010, është përuruar Qendra e Trajnimeve, e cila është pjesë e investimeve të ProCredit Bankws në vlerë prej 23 mijë eurosh. Në kuadër të këtij investimi, është rinovuar gjithë hapësira e Qendrës së Trajnimeve, si dhe është pajisur me projektor, kompjuterë dhe elemente të tjera përcjellëse. Në kuadër të këtij projekti, ProCredit Bank, do të formojë edhe një kënd të bibliotekës me koleksione të librave nga fusha e shkencave ekonomike, që do të jetë në shërbim të studentëve dhe profesorëve të këtyre fushave. Qendra i plotëson të gjitha kushtet e parapara sipas standardeve bashkëkohore për realizim të trajnimeve. Përurimi i kësaj Qendre u bë nga drejtori i BKUK-së - dr. Sali Bashota dhe zëvendës-drejtori i ProCredit Bankës - Florim Lila.

Ramize Bajraktari

KONFERENCA E eIFL NË SUEDI

Suedi (Lund), 05 - 09 gusht 2010

Më 5 - 9 gusht, në Lund të Suedisë, është mbajtur edicioni i 9-të i Konferencës së Përgjithshme të eIFL (Electronic Information for Libraries). Në këtë konferencë, përfaqësues nga Kosova ishte Bukurije Haliti, koordinatore e Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës. Temë e kësaj konference ishte "Qasja e Hapur" (Open Access), ku është diskutuar për strategjitë e zhvillimit të qasjes së hapur në vende të ndryshme dhe për rëndësinë e kësaj konference për përdoruesit e të gjitha profileve; strategjitë për të zhvilluar qasje të hapur në vendet ku është e shtrirë eIFL; trajnimi i bibliotekarëve për dhënien e informacioneve, por edhe për menaxhimin e burimeve elektronike në qasje të hapur (OA).

Të gjitha sesionet e kësaj konference janë përcjellë me debate nga ana e pjesëmarrësve, si për bibliotekarët që duhet të jenë në gjendje të përshtaten me teknologjitë e reja, në mënyrë që të mund të sigurojnë materialet e nevojshme për studiuesit e profileve të ndryshme; për organizimin e bibliotekarëve, në mënyrë që ata të mund të organizohen dhe të përfshihen në bërjen e politikave, të marrin pjesë në konsultime kombëtare dhe të drejtën e autorit, ndikimin e ligjit në interesin më të mirë të bibliotekave etj.

Përfaqësuesja nga Kosova, në këtë Konferencë ka dhënë një pasqyrë të punës së Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, organizimin dhe funksionimin e tij.

Bukurije Haliti

KONGRESI I 76-TË I IFLA-s

Përfaqësues të shteteve në Konferencën e Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare

Gothenburg (Suedi), 10 - 15 gusht 2010

Në Gothenburg të Suedisë nga 10 deri 15 gusht 2010, është mbajtur Kongresi i 76-të IFLA-s (Federata Ndërkombëtare e Institucioneve dhe Shoqatave Bibliotekare). Temë bosht e kongresit të sivjetmë ishte "Qasja e lirë në dije – promovimi i progresit të qëndrueshëm", ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve më të larta bibliotekare të shteteve të ndryshme nga mbarë bota.

Në këtë Kongres, nga Kosova kanë marrë pjesë dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së dhe Besim Kokollari, ish-kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës, të cilët kanë prezantuar kumtesën: "Bibliotekat e Kosovës - historiku dhe zhvillimi", me theks të veçantë për dëmet që i ka shkaktuar Serbia në periudhën e viteve 1990-1999 në institucionet bibliotekare të Kosovës.

Kumtesa e autorëve nga Kosova ishte reagim ndaj dezinformatave të paraqitura nga përfaqësuesit i Serbisë në Kongresin e IFLA-s, të mbajtur në vitin 2009 në Milano të Italisë. Autorët e kësaj kumtese, njoftuan komunitetin bibliotekar lidhur me dezinformatat e paraqitura të përfaqësuesve serbë, Simoncic dhe Vukadinovic, në kumtesën e tyre në kongresin e 75-të të IFLA-s, mbajtur në vitin 2009 në Milano të Italisë. Pas reagimit të përfaqësuesve të Kosovës vitin e kaluar tek instancat më të larta udhëheqëse të IFLA-s, lidhur me dezinformatat e paraqitura të autorëve serbë për bibliotekat e Kosovës, zyrtarë të lartë të IFLA-s i ftuan përfaqësuesit nga Kosova që t'i paraqesin faktet, dëshmitë dhe pikëpamjet e tyre, lidhur me historinë dhe zhvillimin e bibliotekave të Kosovës në Kongresin e 76-të të IFLA-s në Gothenburg të Suedisë.

Gjithashtu, në kuadër të programit të aktiviteteve të Kongresit, është organizuar edhe takimi i radhës i CDNL-së, Konferencës së Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare nga mbarë bota, në të cilën BKUK, nga gushti i vitit 2009, është anëtare e rregullt.

Diana Topalli

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS BKUK-së DHE BKUM-së

Shkup, 20 shtator 2010

Më 20 shtator 2010, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Maqedonisë, nga dy drejtorët e këtyre institucioneve: Sali Bashota dhe Mile Bosheski. Kjo marrëveshje është cilësuar si domethënëse në kuptimin e nevojës së një bashkëpunim në nivel të shkëmbimit të koleksioneve, si dhe të përvojave në fushën e arsimimit bibliotekar.

Akti i nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit

Kjo marrëveshje parasheh që palët të nxisin bashkëpunimin në fushën e shkencave bibliotekare, bibliografisë dhe arkivave, bibliotekës dhe teknologjisë së informacionit.

Për njohuritë e tyre të përbashkëta, arritjet dhe perspektivat e zhvillimit të bibliotekarëve në Republikën e Maqedonisë dhe të Republikës së Kosovës, të dyja palët pajtohen të: shkëmbejnë libra, revista, gazeta, botime elektronike - CD-ROM, mikrofilma dhe llojet të tjera të materialeve të bibliotekës botuar në Maqedoni dhe Kosovë dhe përfaqësim të trashëgimisë kombëtare dhe kulturore të të dy vendeve.

Po ashtu, në këtë marrëveshje parashihet shkëmbimi dhe dhurimi i botimeve bibliografike dhe ato profesionale, pastaj bashkëpunimi në fushën ndërbibliotekare për lehtësimin e kushteve të pagesës së materialeve bibliotekare, si dhe organizimi i trajnimeve dhe seminareve për bibliotekarët nga Maqedonia dhe Kosova në fushën e përgatitjes së projekteve, menaxhimin me proceset e bibliotekës, zhvillimin e marketingut, aftësitë për promovimin e rolit të bibliotekave etj.

Durim Hasaj

"BOOK SLAM" - PËR NXITJEN E TË RINJVE PËR LEXIM

Prishtinë, 24 shtator 2010

Në saje të bashkëpunimit midis Bibliotekës së qytetit të Prishtinës "Hivzi Sylejmani" dhe Institutit Goethe, është organizuar punëtoria "Book Slam", me qëllim të nxitjes së të rinjve për lexim. Kjo punëtori u mbajt më 24 shtator në "Bibliotekën Përkujtimore " - degë e bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, ku morën pjesë punëtorë të bibliotekave nga të gjitha bibliotekat e Kosovës, si dhe përfaqësues nga Presheva dhe Ulqini.

Punëtoria është udhëhequr nga znj. Martit-na Reinhold, zëvendësdrejtore në njërën nga bibliotekat më moderne dhe më inovative të rinisë në Dresden të Gjermanisë.

Ajo prezantoi metodat që aplikohen për t'ua bërë lexuesve sa më atraktiv librin dhe për ta zgjuar kureshtjen e tyre për lexim.

Znj. Bettina Radner, drejtoreshë e Institutit Goethe në Beograd, përveç vlerësimit të kësaj punëtori, mënyrës së mirë të organizimit dhe mikpritjes nga organizatori, premtoi se ky bashkëpunim i mirë do të vijojë edhe në të ardhmen.

Bukurije Haliti

KATALOG: LIBRI DHE PERIODIKU I VJETËR DHE I RRALLË (TITUJ TË ZGJEDHUR), PRISHTINË, BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, 2010, 98 F.

Katalogu i titujve të zgjedhur të koleksionit të Librit dhe Periodikut të Vjetër dhe të Rrallë paraqet katalogun e parë, më të plotë, të këtij lloji i cili ka për qëllim, ofrimin e informacionit për përdorues në një botim të veçantë dhe sensibilizimin e opinionin për të ndihmuar pasurimin e koleksioneve të veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, si ruajtëse të trashëgimisë së shkruar dhe intelektuale e kulturore të Kosovës.

Katalogu botohet më rastin e organizimit të Ekspozitës së Librit dhe Periodikut të vjetër dhe të Rrallë, në kuadër të Javës së Bibliotekës në Kosovë dhe paraqet një pjesë të titujve të përzgjedhur të Koleksioneve të Veçanta, të titujve nga Koleksioni i Librit dhe Periodikut të Vjetër dhe të Rrallë. Është bërë një përzgjedhje e titujve më të spikatur sipas kritereve gjuhësore dhe të raritetit. Njësitë e përshkruara japin të dhënat themelore dhe janë të radhitura në mënyrë kronologjike. Në radhitjen kronologjike njësitë kanë edhe radhitje alfabetike dhe po ashtu janë renditur me numër rendor. Janë përfshirë edhe shënimet më të rëndësishme për identifikimin e titujve, si: autori, titulli, vendi i botimit, botuesi, viti i botimit, shënime shtesë. Në rastet kur mungon ndonjëri prej këtyre elementeve, janë marrë shenjat latine që përdoren si standarde në përshkrimin bibliografik të materialeve, si për shembull në mungesë të vendit të botimit, është përdorur shkurtesa me shenjën –[s.l.], në mungesë të botuesit, është përdorë -[s.n.], ndërsa në mungesë të vitit të botimit – [s.a.].

Katalogu i Librit dhe Periodikut të Vjetër dhe të Rrallë shpresojmë të plotësojë kërkesat e lexuesve për informacion për literaturën me karakter të vjetër dhe të rrallë, dhe të veçantë.

Katalogu përfshin 785 tituj nga libri i vjetër dhe i rrallë, si dhe 32 tituj nga periodiku i vjetër dhe i rrallë.

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË 4, "NGA BIBLIOGRAFIA TE WEBOGRAFIA E LIBRIT SHQIP" EDICIONI IV (PRISHTINË, 23-24 NËNTOR 2009), PRISHTINË, BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, 2010, 101 F.

Ky botim, që është i katërti me radhë, duke përfshirë këtu edhe dy nga këto të përmbledhura në botime të veçanta në revistën Bibliothecae, revistë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, përfshin kumtesat nga Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, me temën: "Nga bibliografia te webografia e librit shqip", Edicioni IV (Prishtinë, 23-24 nëntor 2009), e organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

Këto kumtesa janë lexuar me rastin e kësaj konference, nga njohës dhe ekspertë me formim bibliotekar nga Shqipëria dhe Kosova. Pra, kumtesat përfshijnë probleme dhe qasje që janë të natyrës së përbashkët në kuptimin nacional, për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, në përputhje me zhvillimet e reja të teknologjive në shkencën e bibliotekës dhe informacionit.

Botimi përfshin kumtesat e këtyre specialistëve dhe hulumtuesve nga fusha bibliotekare: Afërdita Sharxhi: "Bibliografia e arsyetuar – kontribut në fushën e studimeve"; Tahir Foniqi: "Kontribut për një bibliografi (Libri shqip: bibliografi 1944-1984)"; Maksim Gjinaj: "Disa drejtime themelore të kërkimit bibliografik. Shembuj dhe refleksione nga puna për përgatitjen e Bibliografisë retrospektive të librit shqip (1913-1944)"; Muharrem Halili: "Katalogu alfabetik – normat dhe standardet"; Ramazan Vozga: "Veçori të hartimit të bibliografive retrospektive"; Farfuri Xhaja: "Standardet e përshkrimit bibliografik dhe bibliografia kombëtare"; Fahrije Simnica: "Libri i rrallë dhe i vjetër dhe standardet e përshkrimit bibliografik"; Jehona Shala: "Sfidat e përshkrimit bibliografik të librit shqip"; Nehat Krasniqi: "Përshkrimi bibliografik i dorëshkrimeve arabike"; Besim Kokollari: "Automatizimi i bibliografive: nevoja për standardizimin e përcaktuesve"; Behije Luga: "Përgatitja e bibliografisë kombëtare në formë elektronike"; Violeta Viso: "Ekzemplari i detyruar dhe bibliografia kombëtare".

Pra, ky botim mbështetur në problemin që është trajtuar në këtë konferencë, si dhe të qasjes së ekspertëve për tema e probleme të caktuar nga kjo fushë, mbetet një dokument i rëndësishëm dhe me vlerë të veçantë për opinionin bibliotekar dhe atë kulturor të të dy vendeve.